



Regjistrimi Dokumenti Procedura Në: / Dokument No. / Dokument	30-01-2023	3	viti god year
Organizimi Organizimi Org. titull	1103/2023	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHEK	1103/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.1223/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 1223/2022 të datës 20.12.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rr "

Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1223/2022 e datës 20.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja , e punësuar në pozitën Zyrtare e gjendjes civile 1, në Sektorin e Gjendjes Civile në Komunën e Drenasit, më datë 20.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me pagën jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve te organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 12.01.2022, ka dërguar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave me rastin e vendosjes sa i përket kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8227/2022 të datës 20.12.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktvendim për krijimin e marrëdhënies së punës i datës 03.11.1990; shkresë emërimi për pozitën ofiqare prej datës 03.08.2001 deri më 01.03.20ë pë02; Njoftimi i datës 15.11.2022 me nr.070/01-57514 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; E-mail zyrtar i datës 23.11.2022-kërkesë për pagën jubilarë; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.12.2022 me numër protokollit 8554/2022 ; Përgjigje nga organi i punësimit e datës 12.01.2023 me numër protokollit 220/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 07.06.2012 me nr.01-120-8158; Libreza e punës me nr.të regjistrimit 195 si dhe nr. serik 233082 ; Vendim i datës 15.05.2015 me nr.120-65434/2015 i lëshuar nga kryetari i komunës së Drenasit; Lista e Pagave e muajit Nëntor 2017/Dëshmia se ankuesja e ka marrë pagën jubilarë dhe Kërkesa për pagë jubilarë e datës 04.11.2022 me nr.01-070/01-57514 e parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është *e pabazuar, sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se duhet ti bëhet kompensimi i pagës jubilarë për 20 vite bazuar në Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, ndërsa e njëjta konfirmon se ka përvojë pune 29 vjet e gjashtë muaj.

Kryetari i Komunës së Drenasit me datë 30.11.2015 ka nxjerr vendimin me nr.120-65434/2015 duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.06/29 të datës 15/05/2015 , ku sipas dëshmive të ofruara nga ankuesja i pranohet përvoja e punës prej 22 vite e 6 muaj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, ka konstatuar se ankueses i është bërë kompensimi i shpërblimit jubilar në muajin nëntor 2017 dhe at në shumën 93.56 Euro ,rrethanë që argumentohet përmes listës së pagave që është në shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvojës (jubile)“* si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *“Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune“*, rrjedhimisht nga arsyet e mësipërme konstatohet fakti se ankuesja shpërblimin jubilar për 20 vite përvojë pune e ka marrë në muajin Nëntor 2017,dhe mbi këto arsye të potencuara më lartë pretendimi i ankueses është i pabazuar dhe që rezulton me refuzim të ankesës.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës




për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1223/2022, datë 30/01/2023

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses _____
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Drenasit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

